Neni 14: Një aksion nuk mund të përpjesëtohet. Në rast se një aksion i vetëm do të jetë në pronësi të më shumë se një poseduesi. Neni 404 i Kodit Tregtar Turk do të zbatohet.

Përgjegjësia e aksionarëve:

Neni 15: Aksionarët do të jenë përgjegjës vetëm për shumën e aksioneve që ata zotërojnë.

Pasojat e mbajtjes së Aksioneve:

Neni 16: Mbajtja e aksioneve do të kërkojë klauzola aprovuese të kontratës kryesore dhe vendime të Asamblesë së Përgjithshme.

Kjo do të zbatohet edhe për ato që kanë pasur aksione të përfituara përmes trashëgimisë, ose arsye të tjera.

Shtimi i kapitalit:

Neni 17:

Kur gjykohet e nevojshme, kapitali i kompanisë do të shtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme brenda kornizës së rregullave ligjore. Zbatimi i një vendimi të tillë, që do të thotë një ndryshim i Kontratës Kryesore, në çdo rast kryhet me lejen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë. Sidoqoftë, një vendim i tillë nuk mund të merret nëse nuk paguhet i gjithë kapitali.

Shtimi i kapitalit mund të jetë në format që aksionarët bashkohen në shtim, aksionarët e rinj pranohen në kompani ose fondet rezervë të fondeve të jashtëzakonshme rezervë i shtohen kapitalit. Në rast se Asambleja e Përgjithshme do të vendosë shtimin e kapitalit duke emetuar aksione, aksionarët aktualë do të kenë përparësi nga shuma e tyre aktuale ose aksionet për të blerë aksione të sapo emetuara. Asambleja e Përgjithshme që vendos për kushtet, periudhën dhe procedurat e përdorimit të kësaj të drejte përparësie. Kur kapitali shtohet duke shtuar fonde rezervë të jashtëzakonshme, secili aksionar do të posedojë aksione të reja pa bërë asnjë pagesë.

Pakësimi i kapitalit:

Neni 18:

Kapitali mund të pakësohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe brenda kornizës së dispozitave të Kodit Tregtar Turk. Procedurat e pakësimit të kapitalit do të përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme. Marrja dhe zbatimi i një vendimi të tillë, i cili në një rast do të thotë një ndryshim në Kontratën Kryesore, do t'i nënshtrohet lejes së Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë. Kur procedurat përkatëse do të përfundojnë, kjo çështje regjistrohët dhe shpallet në përputhje me rregullat.

Emetimi i letrave me vlerë:



Neni 18:

Kjo shoqëri mund të emetojë letra me vlerë me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme brenda kuadrit të dispozitave të Kodit Tregtar Turk dhe me miratimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë. Pa mbledhur çmimin e plotë të letrave me vlerë të emetuara, Shoqëria mund të mos emetojë një grup tjetër të letrave me vlerë të jashtëzakonshme. Shuma totale e letrave me vlerë që do të emetohen nuk mund të jetë më e lartë se kapitali i paguar.

Neni 20: Në rast se aksionet e emetuara të shoqërisë ose letrat me vlerë humbasin, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit aktual.

SEKSIONI III

Përcaktimi i detyrave të Bordit të Drejtorëve dhe administrimi i shoqërisë

Administrimi

Neni 21: Brenda kornizës së dispozitave të Kodit Tregtar Turk, Shoqëria do të administrohet nga Bordi i Drejtorëve me 7 anëtarë. 3 anëtarë të Bordit të Drejtorëve do të zgjidhen midis aksionarëve ndërsa 3 anëtarët do të caktohen nga kapitali privat dhe 2 anëtarët do të caktohen nga kapitali shtetëror.

Bordi i parë i Drejtorëve do të përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

- Përfaqësuesi i Kapitalit Privat:

1 - Paul Millioon (adresa: Ankara Palas)

- Përfaqësuesi i Kapitalit Privat:

2 - Niyazi Artunkal (adresa: Karanfil Sokak. Nr: 9-A, Yenişehir - Ankara)

- Përfaqësuesi i Kapitalit Privat:

3 - Celal Imre (adresa: izmir Cad. Nr: 32)

Përfaqësuesi i Kapitalit Privat:

4 - Macit Selem (adresa: iŞ Bankasi Apt. Ataturk Bulvan, Yenişehir - Ankara)

Përfaqësuesi i Kapitalit Privat:

5. Zeki Turgay (adresa: Bahçueveler 61 nci Sokak No:9)

Anëtarët e mësipërm të Bordit të Drejtorëve janë zgjedhur për një mandat 3-vjeçar.

Përfaqësimi i Aksionarëve në Bordin e Drejtorëve

Neni 22: Anëtari i Bordit të Drejtorit zgjidhet midis kandidatëve, të cilët janë propozuar nga aksionarët që zotërojnë aksione me vlerë minimale prej 300 000,00 TL.



Mandati i Anëtarëve:

Neni 23: Anëtarët e Bordit të Drejtorëve zgjidhen për tre vjet. Anëtarët, të cilët kanë përfunduar mandatin e tyre, mund të rizgjidhen. Asambleja e Përgjithshme ka kompetencën për të zëvendësuar anëtarët e Bordit të Drejtorëve në çdo kohë.

Letrat me vlerë të Besuar nga Anëtarët:

Neni 24: Në përputhje me nenin 313 të Kodit Tregtar Turk, anëtarët e Bordit të Drejtorëve duhet t'i besojnë Shoqërisë çdo pjesë të aksioneve të tyre, e cila do të jetë e barabartë me 2,500.00 TL.

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve:

Neni 25: Bordi i Drejtorëve duhet të mbledhet një të paktën një herë në muaj me ftesë të Presidentit të tij. Kryesisht takimet e Bordit të Drejtorëve do të mbahen në selinë e shoqërisë. Sidoqoftë, në raste të jashtëzakonshme, mbledhja mund të mbahet në një vend tjetër.

Kompetenca te Bordit të Drejtorëve:

Neni 26: Bordi i Drejtorëve administron dhe përfaqëson shoqërinë.

I gjithë dokumentacioni i lëshuar nga Shoqëria dhe çdo kontratë e përfunduar do të jetë e vlefshme vetëm nëse ato mbajnë vulën e kompanisë ose emrin e saj të printuar shoqëruar me nënshkrimin e të paktën një anëtari të Bordit të Drejtorëve. Një qarkore e nënshkrimeve duhet të përgatitet dhe t'u shpërndahet autoriteteve kompetente, institucioneve, bankave dhe palëve të tjera të interesuara. Një qarkore e tillë tregon personat, të cilët kanë kompetenca të nënshkruajnë në emër të Bordit të Drejtorëve, në çfarë mënyre ata mund të nënshkruajnë dokumentacionin, dhe për cilat procedura nënshkrimet e tyre do të ishin në nivelin e parë dhe të dytë.

Administratori

Neni 27:

Bordi i Drejtorëve mund të transferojë disa nga kompetencat e tij tek një prej anëtarëve që ata zgjedhin ndërmjet tyre.

Anëtari i tillë do të quhet Administratori.

Bordi i Drejtorëve do t'i japë autorizimin e plotë Administratorit, i cili ka kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm, për të administruar Kompaninë pas themelimit të saj përfundimtar, me kusht që ai të qëndrojë brenda kornizës së vendimeve të Bordit të Drejtorëve gjithashtu do të përcakttojë paga që do t'i paguhet Administratorit.

Më poshtë janë parashikuar kompetencat, që mund t'i jepen çdo administratori, i cili do të jetë përgjegjës para Bordit të Drejtorëve për çështjet financiare, çështjet ligjore dhe marrëdhëniet e shoqërisë me Bankat:

a) të përfaqësojë shoqërinë pranë institucioneve zyrtare dhe personave fizikë si në Turqi ashtu edhe jashtë saj.



- b) të menaxhojë çështjet aktuale të shoqërisë.
- c) të emërojë inxhinierë, oficerë, agjentë, ndihmës dhe punëmarrës, të përcaktojë pagat e tyre, t'i shkarkojë nga detyra.
- ç) të administrojë dhe mbikëqyrë sektorët e kontabilitetit industrial dhe administrativ.
- d) të administrojë shërbimet prodhuese të shoqërisë.
- e) të përgatisë programe prodhimi dhe të zgjedhë materialet që do të përpunohen në këndvështrimin e situatës së pajisjeve dhe ngarkesës së punës së seminareve.
- f) të administrojë dhe mbikëqyrë kërkimet.
- g) të blejë dhe shesë të gjitha llojet e lëndëve të para, pajisjeve dhe prodhimit të përgjithshëm.
- h) të lidhë kontrata për të gjitha llojet e procedurave tregtare dhe industriale në lidhje me funksionimin e shoqërisë.
- j) të drejtojë dhe kontrollojë montimin e materialeve të huaja.
- k) të përcaktojë nënkontraktorët për prodhimin dhe montimin (nëse është e nevojshme) brenda kornizës së çmimeve dhe periudhave përkatëse dhe pa ndonjë përgjegjësi që mund të pengojnë funksionimin e mirë të shoqërisë.
- l) të nënshkruajë korrespondencën.

Me miratimin e Bordit të Drejtorëve, administratori mund t'i japë një menaxher operacionesh të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij të përmendura në nënparagrafët a. b c.d. d, e. f.g.i.j.k dhe l me kusht që përgjegjësitë e tij të vazhdojnë.

Ky menaxher Operacionesh do të emërohet me kërkesë të administratorit nga Bordi i Drejtorëve.

Çështje të tjera:

Neni 28:

Dispozitat e Ligjit të Detyrimeve dhe Kodit Tregtar do të zbatohen për formatin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve; kuorumi i kërkuar për takime dhe diskutime; procedura e votimit; detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve; procedura që do të zbatohet kur një anëtar i Bordit të Drejtorëve vdes ose nuk mund të përmbushë detyrat e tij.

Paga e anëtarëve:

Neni 29:

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, do të paguhem me page dhe honorare që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme brenda kornizave të dispozitave të kësaj kontrate kryesore.

Personat e mëposhtë janë zgjedhur si auditorë të parë për një mandat prej një viti:

1- Apdullah Zeki Polar

2- Nami Onur



Kufizimet për të qenë auditor

Neni 31: Në qoftë se nuk lejohen nga Asambleja e Përgjithshme, aksionarët, të cilët kanë përfunduar mandatet e tyre si anëtar të Bordit të Drejtorëve mund të mos punojnë si zyrtarë për shoqërinë. Dispozitat e Kodit Tregtar do të zbatohet për çështje si zgjedhja, largimi, zëvendësimi, vdekja ose dorëheqja e auditorëve.

Detyrat e Auditorëve

Neni 32: Përveç detyrave të përcaktuara në nenin 354 të Kodit Tregtar, auditorët janë të autorizuar të bëjnë rekomandime për Bordin e Drejtorëve për të marrë masa që auditorët i shohin të nevojshme për administrim efektiv të shoqërisë dhe për të mbrojtur interesat e shoqërisë gjithashtu pasi ata mund të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme për t'u mbledhur dhe mund të përcaktojnë rendin e ditës. Ata do të jenë bashkërisht përgjegjës për përmbushjen e detyrave të caktuara nga kontrata kryesore.

Njoftimi i Mbledhjes së Jashtëzakonshme

Neni 33: Auditorët janë të detyruar të plotësojnë në kohën më të shkurtër

njoftimi i Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme në një mbledhje të jashtëzakonshme.

Me kërkesë të aksionarëve

Neni 34: Shqyrtimi nga auditorët i kërkesave të bëra nga aksionarët kundër anëtarëve të Bordit të Drejtorëve do t'i nënshtrohet nenit 359 të Kodit Tregtar.

Auditorët private

Neni 35: Asambleja e Përgjithshme, kur e sheh të nevojshme, Ministria e Ekonomisë dhe Tregtisë mund të caktojë auditorë privatë për hetimin dhe shqyrtimin e çështjeve të caktuara. Këto auditorë do të kenë të gjitha të drejtat dhe autoritetin e dhënë auditorëve të përfshirë në kompani nga dispozitat e kodit tregtar dhe kontrata kryesore e shoqërisë.

Neni 36: Kur Asambleja e Përgjithshme do të vendosë të ngrejë një padi kundër Bordit të Drejtorëve, auditorët do ta ndërmarrin këtë vendim.

Pjesëmarrja në Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve

Neni 37: Auditorët mund të jenë të pranishëm në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve me kusht që ata të mos mund të votojnë dhe të marrin pjesë në diskutime, dhe ata mund të marrin çdo çështje të nevojshme në agjendën e mbledhjeve të zakonshme ose të jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve dhe Asamblesë së Përgjithshme.

Paga e Auditorëve

Neni 38: Auditorëve do t'u jepet paga mujore ose vjetore që përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme.



SEKSIONI V

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme

Neni 39: Neni 39: Aksionarët e shoqërisë mbledhen të paktën një herë në vit si Asamble e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme, e cila mbledhet në përputhje me dispozitat e ligjit dhe kësaj kontrate kryesore, do të përfaqësojë të gjithë aksionarët.

Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e mbledhur sipas përcaktimeve të mësipërme do të jenë të detyrueshme për aksionarët që kanë votuar kundër dhe ata që mungojnë. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në mënyrë të zakonshme ose të jashtëzakonshme. Një mbledhje e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet të paktën një herë në vit dhe brenda tre muajsh pas përfundimit të vitit fiskal. Në këtë mbledhje, shqyrtohen operacionet e përgjithshme vjetore dhe llogaritë e Kompanisë, si dhe çështjet e tjera të rendit të ditës, dhe merret çdo vendim i kërkuar. Mbledhja e jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet në situatën dhe kohën që kërkohen nga shoqëria. Gjatë kësaj mbledhje merren vendime në përputhje me dispozitat e Kodit Tregtar dhe kësaj kontrate kryesore.

Neni 40: Kur konsiderohet e nevojshme, Ministria e Ekonomisë dhe e Tregtisë mund të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në mbledhje të jashtëzakonshme dhe përgatit dhe njofton rendin e ditës së kësaj mbledhje.

Vendi i mbledhjes:

Neni 41: Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër të përshtatshëm në vendin ku ndodhet selia e shoqërisë.

Komisioneri i Ministrisë

Neni 42: Të gjitha mbledhjet e zakonshme ose të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme duhet t'i njoftohen Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë të paktën njëzet ditë më parë, dhe kopja e rendit të ditës dhe dokumentet përkatëse duhet t'i dërgohen Ministrisë. E gjithë mbledhja duhet të mbahet në prani të Ministrit të Ekonomisë dhe Komisionerit të Tregtisë. Vendimet e marra në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme në mungesë të komisionerit nuk janë të vlefshme.

Kuorumi

Neni 43: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe kuorumi i kërkuar do t'i nënshtrohen dispozitave të Kodit Tregtar.

Të drejtat e votës

Neni 44: Nëse e kundërta nuk përcaktohet në Kodin Tregtar ose në kontratën kryesore, aksionarët që do të jenë të pranishëm në mbledhjet e zakonshme ose të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme, do të kenë një votë për çdo dyqind aksione, por asnjë aksionar nuk do të ketë më shumë se dhjetë vota.

Mënyra e përfaqësimit




Neni 45: Aksionarët mund të përfaqësohen vetë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një përfaqësues që ata do të zgjidhnin midis aksionarëve ose ndryshe. Përfaqësuesit, të cilët janë gjithashtu aksionarë, janë të autorizuar të përdorin votat e tyre, si dhe ato që i përkasin aksionarit që ata përfaqësojnë. Format i këtij autoriteti përcaktohet dhe njoftohet nga Bordi i Drejtorëve. Nëse uzufrukti dhe posedimi i një aksioni u përkasin atyre të përfaqësuar. Në rast mosmarrëveshjeje, do të jetë ai që ka uzufruktin që do të vëzhgojë dhe votojë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Aksionarët, të cilët individualisht nuk posedojnë numër të mjaftueshëm të aksioneve për të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, do të caktojnë një përfaqësues midis tyre.

Karta e Hyrjes

Neni 46: Në mënyrë që të identifikohet kuorumi i kërkuar, aksionarët, të cilët do të jenë të pranishëm në asamblenë e Asamblesë së Përgjithshme, duhet të paraqesin një javë para mbledhjes aksionet e tyre ose provat e mbajtjes së këtyre aksioneve (vetë ose me anën e përfaqësuesve) në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër që do të caktohet nga Bordi i Drejtorëve dhe ata do të marrin një kartë hyrëse e cila tregon shumën dhe numrin e aksioneve.

Periudha e sipërpërmendur prej një jave do të jetë e vlefshme për situata normale, por në rast të një forcë madhore aksionarët mund të aplikojnë brenda kornizës së rregullave deri në mëngjesin e mbledhjes dhe mund të marrin pjesë në mbledhje.

Kartat hyrëse do të jenë të vlefshme për mbledhjen e sytë, nëse kuorumi I kërkuar nuk do të arrihet në mbledhjen e parë. Por prokura dhe kompetencat që i jepen atyre, që do të marrin pjesë në mbledhje si përfaqësues, duhet të mbeten të përhershme.

Lista e aksionarëve

Neni 47: Një listë e aksionerëve ose përfaqësuesve, të cilët do të jenë të pranishëm në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, ku shënohen emrat, mbiemrat dhe shumën e aksioneve në pronësi do të përgatitet. Para fillimit të diskutimeve, kjo listë do të miratohet nga Bordi i Drejtorëve dhe do të vendoset në një vend që mund të shihet lehtësisht nga aksionarët. Për më tepër, një kopje e kësaj liste duhet t'i jepet sekretarisë së Asamblesë së Përgjithshme.

Koha kur nuk transferohen aksionet

Neni 48: Brenda shtatë ditësh që korrespondon me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Aksioent e shoqërisë nuk mund t'i transferohen palëve të tjera.

Zgjedhje e kryetarit, sekretarit, zyrtarëve votues gjatë procesit të votimit

Neni 49: Kryetari i Bordit të Drejtorëve do të drejtojë Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Në mungesë të Kryetarit, zëvendës kryetari do të marrë drejtimin. Në mungesë të Kryetarit dhe zëvendës kryetarit, kryetari do të caktohet nga Bordi i Drejtorëve. Kryetari do të jetë përgjegjës për diskutimet që do të mbahen në përputhje me rregullat dhe për procesverbalin që do të mbahet në përputhje me dispozitat e ligjit dhe kontratën kryesore.

Dy aksionerë, që mbajnë numrin më të lartë të aksioneve midis aksionerëve të pranishëm në Asamblenë e Përgjithshme, do të mbledhin votat.



Në rast se këta aksionarë do ta refuzojnë këtë detyrë, ky rregull do të ndiqet. Sekretari i Asamblesë së Përgjithshme zgjidhet midis aksionerëve ose ndryshe nga Kryetari dhe zyrtarët votues.

Përgatitet një listë e aksionerëve ose përfaqësuesve të autorizuar të pranishëm në Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë, e cila përmban emrat, vendet, aksionet dhe votat e tyre. Pasi të miratohet nga pjesëmarrësit, kjo listë do të t'i bashkëngjitet procesverbalit. Ajo do t'u vihet në dispozicion palëve të interesuara sipas kërkesës.

Nënshkrimi, regjistrimi dhe njoftimi i procesverbalit

Neni 50: Në mënyrë që vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të jenë të vlefshme, do të merret procesverbali, i cili përshkruan vendimet dhe tregon aksionarët që kanë votuar kundër dhe komisionerin e pranishëm në mbledhje.

Nëse aksionarët do të autorizonin Kryetarin dhe zyrtarët e votimit të nënshkruajnë procesverbalit me një letër autorizimi, ata mund të nënshkruajnë vetëm procesverbalin. Çdo dokumentacion që provon se mbledhja është njoftuar rregullisht në përputhje me rregullat gjithashtu do t'i bashkëngjitet këtyre procesverbaleve dhe përmbajtja e tyre do të bëhet me shkrim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës menjëherë të regjistruar në regjistrin tregtar një kopje të aprovuar të atyre procesverbaleve, dhe për njoftimin e përmbledhjes së tij.

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

Neni 51: Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme:

- a) Të diskutojë dhe të vendosë mbi çështjet që dalin jashtë autoritetit të Bordit të Drejtorëve
- b) Të japë leje të posaçme Bordit të Drejtorëve për të përcaktuar këtë leje të posaçme dhe të përcaktojë afarizmin e shoqërisë.
- c) të miratojë, refuzojë, diskutojë dhe kërkojë ri-përgatitjen e raporteve, bilancin, llogaritë e fitimit / humbjes dhe librin e aktiveve, të cilat do të përgatiten nga Bordi i Drejtorëve dhe Auditorët; të vendosë fshirjen e debive të Bordit të Drejtorëve ose tjetër; për të përcaktuar dividendët që do të shpërndahen duke përcaktuar amortizimin: për të zgjedhur dhe zëvendësuar (kur kërkohet) anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe auditorët; për të përcaktuar shumën e fondeve që do të alokohen për anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe auditorët.

d) Për të vendosur për dhënien e lejes ose ndryshe për çështjet që Anëtari i Bordit të Drejtorëve duhet të marrë leje në radhë të parë.

e) të lejojë përdorimin e pasurive të paluajtshme të kompanisë për sigurimin e kredive përmes pengut ose letrave me vlerë: për të marrë vendime për çështjet e rendit të ditës në lidhje me administrimin ose zbatimin e kontratës kryesore.

Kompetencat e tjera

Neni 52: Kompetencat e sipërpërmendura nuk janë të kufizuara. Në përputhje me Dispozitat e Kodit Tregtar, Asambleja e Përgjithshme do të autorizohet të marrë vendime për të gjitha çështjet direkt ose indirekte të rëndësishme për shoqërinë siç janë administrimi i punëve të shoqërisë dhe ndryshimi i kontratës kryesore.



Mos mbajtja e përgjegjësisë

Neni 53: Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme për shqyrtimin e bilancit të gjendjes përfshijnë mos mbajtjen e përgjegjësisë të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Drejtorit dhe Auditorëve. Sidoqoftë, nëse nuk janë shënuar të gjitha pikat në Bilanc ose do të ishin për gatitur gabimisht anëtarët e Bordit të Drejtorëve, Drejtori dhe Auditorët nuk mbajnë përgjegjësi dhe vendimi i marrë nuk do të jetë i vlefshëm.

Aksionarët që nuk mund të marrin pjesë në diskutime

Neni 54: Aksionarët as nuk mund të marrin pjesë dhe as të përdorin votat kur në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme diskutohen çështje ku ata janë përfshirë personalisht.

Shtyrja e mbledhjes

Neni 55: Me kërkesë të aksionerëve, të cilët përfaqësojnë shumicën ose neni mbi miratimin e bilancit do të shtyhet pesëmbëdhjetë ditë dhe ftesa për mbledhjen e dytë do të bëhet në përputhje me rregullat. Në mbledhjen e dytë, kërkesa nga shumica e aksionerëve për të shtyrë diskutimet për një mbledhje tjetër duhet të bëhet para se të bëhet shpjegimi për çështjet që u refuzuan në mbledhjen e mëparshme. Përndryshe, këto kërkesa nuk do të jenë të vlefshme.

Kundërshtim kundër vendimeve

Neni 56: Kundërshtimet kundër vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe formatet dhe kushtet përkatëse do t'i nënshtrohen dispozitave të Kodit Tregtar.

Ndryshimi i neneve të statutit

Neni 57: Përmirësimi dhe zbatimi i të gjitha ndryshimeve në Kontratën kryesore do t'i nënshtrohen miratimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë.

Këto ndryshime do të jenë të vlefshme deri në datën e njoftimit të tyre pasi të jenë miratuar dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar në përputhje me rregullat përkatëse.

Mënyra e Votimit

Neni 58: Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme votimi bëhet i hapur.

Sidoqoftë, votimi i fshehtë bëhet me kërkesë të aksionerëve, të cilët zotërojnë një të dhjetën e kapitalit të përfaqësuar nga aksionarët aktualë.

Dokumentacioni që do t'i dërgohet Ministrisë

Neni 59: Katër kopje të raporteve të Bordit të Drejtorëve dhe Auditorëve, bilanci vjetor, procesverbali i Asamblesë së Përgjithshme dhe lista e aksionarëve të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, e cila tregon emrat dhe shumën e aksioneve të tyre, do të dërgohen në Ministri i Ekonomisë dhe Tregtisë brenda një maksimumi një muaj pas mbajtjes së mbledhjes ose një dokument i tillë mund t'i paraqitet Komisionerit të Ministrisë të pranishëm në mbledhje.



SEKSIONI VI

LLOGARITE VJETORE

Viti Fiskal

Neni 60: Viti fiskal i shoqërisë fillon nga data 1 janar dhe mbaron në ditën e fundit të dhjetorit. Por përjashtimisht viti i parë i llogaritjes mbulon periudhën midis datës të themelimit të shoqërisë dhe ditës së fundit të janarit të vitit përkatës.

Bilanci dhe të ndryshme:

Neni 61: Një herë në çdo 6 muaj një bilanc që tregon të ardhurat dhe detyrimet e shoqërisë do të lëshohet nga bordi i drejtorëve dhe do t'u dorëzohet auditorëve. Aktivet dhe libri i llogarive, bilanci, llogaritë e fitimit dhe humbjes do t'u paraqiten auditorëve për shqyrtim të paktën para datës së njoftuar për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme. Këto llogari do të paraqiten nga bordi i drejtorëve në asamblenë e përgjithshme. Aksionari mund të marrë pjesë në mbledhje dhe mund të kontrollojë aktivet dhe librin e llogarive, llogaritë e fitimit dhe humbjes, bilancin, raportet e auditorëve dhe bordit të drejtorëve dhe mund të marrë një kopje të secilës.

SEKSIONI VII

Shpërndarja e fitimit dhe fondeve rezervë shpërndarja e fitimit neto

Neni 62: Fitimi neto do të përcaktohet me zbritjen e të gjitha llojeve të shpenzimeve të përgjithshme, shpërblimi i primeve dhe shumat e ngjashme dhe vlerat e amortizimit dhe ekuivalentët e tyre që i paguhen punëmarrësve nga këto shpenzime nga të ardhurat e shoqërisë të gjeneruara si rezultat i veprimeve të saj gjatë një viti. Ky fitim do të shpërndahet si më poshtë:

- a) 5% do të mbahen si fonde rezervë ligjore
- b) nga shuma tjetër do të zbriten taksat ligjore të llogaritura për fitimin neto
- c) pas zbritjes së shumës së përcaktuar në pikën a) dhe b) më lart 10% e fitimit neto do t'i shpërndahet punëmarrësve dhe 11% do t'i shpërndahet anëtarëve të bordit të drejtorëve.
- d) Pas zbritjes së shumave të përmendura në paragrafët a, b dhe c më sipër:
 - 1-50% e pjesës së mbetur të fitimit neto do të mbahet si rezervë për 10 vite si fonde të jashtëzakonshme (më pas shuma që do të mbahet si rezervë do përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme)
 - 2-Nga pjesa e mbetur shuma që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme do t'i shpërndahet aksionerëve si dividend.
 - 3-Dhe pjesa e mbetur do t'i shtohet fondeve të jashtëzakonshme rezervë.

Përdorimi i fondeve të jashtëzakonshme rezervë

Neni 63:



Lloji i përdorimit të fondeve të jashtëzakonshme rezervë do të përcaktohet lirisht nga asambleja e përgjithshme. Pra nëse, fitimi i një viti kontabël nuk është i mjaftueshëm për të shpërndarë fitimin tek aksionarët, fondet e jashtëzakonshme rezervë mund të alokohen për këtë veprim.

Periudha e shpërndarjes së fitimit

Neni 64: Datat dhe lloji i shpërndarjes së fitimit vjetor tek aksionarët përcaktohet nga asambleja e përgjithshme me sugjerim të bordit të drejtorëve. Fitimet e shpërndara në bazë të kësaj kontrate kryesore nuk mund të merren përsëri.

Fondet e rezervës së përbashkët

Neni 65: Nëse një fond rezervë i përbashkët i rezervuar nga kompania ka arritur 25% të kapitalit të shoqërisë, asnjë fond rezervë nuk do të rezervohet më. Por nëse kjo shumë zvogëlohet për ndonjë arsye, atëherë fondet rezervë do të rezervohen, derisa të arrihet niveli i 25%. Rezervat e fondeve do të depozitohen në vendet e kërkuara ligjërisht.

Shpërndarja e fondeve rezervë

Neni 66: Në rast të mbylljes së mbarimit të afatit të veprimtarisë së shoqërisë ose mbylljes likuidimi dhe veprimet do të kryhen kur këto fonde rezervë do t'i shpërndahen aksionerëve sipas aksioneve të tyre.

SEKSIONI VIII

Mbyllja dhe likuidimi i shoqërisë

Mbyllja e shoqërisë sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme

Neni 67: Bordi i drejtorëve mund të ftojë Asamblenë e Përgjithshme në një mbledhje për të diskutuar mbylljen dhe likuidimin e kompanisë për ndonjë arsye ose për të diskutuar vazhdimin e saj.

Anulimi sipas vendimit të gjykatës

Neni 68: Shoqëria mbyllet për arsye të përmendura në ligjin tregtar ose sipas vendimit të gjykatës. Përveç kësaj, ajo mund të mbyllet me vendim të asamblesë së përgjithshme brenda rregulloreve ligjore.

Likuiduesi

Neni 69: Nëse shoqëria për ndonjë arsye përveç falimentimit mbyllet, likuidatori do të emërohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Kushte të tjera

Neni 70: Lloji i likuidimit, procesi i procedurave të likuidimit dhe përfundimi i tyre dhe kompetencat dhe detyrat e likuidatorëve do t'i nënshtrohen rregullimeve ligjore.



SEKSIONI IX

TË NDRYSHME

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 71: Mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet shoqërisë dhe aksionerëve të saj për aktivitetin e shoqërisë gjate dhe/ose likuidimit të shoqërisë do të zgjidhet në gjykatën e vendit ku ushtron aktivitetin shoqëria.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që lindin ndërmjet aksionerëve dhe shoqërisë në fjalë, të cilat mund të ndikojnë tek të drejtat e shoqërisë, do të zgjidhet në gjykatën e vendit ku ushtron aktivitetin shoqëria.

Statuti

Neni 72: Statuti i shoqërisë do të printohet dhe një kopje do t'i dorëzohet çdo aksionari të shoqërisë. Shoqëria vetëm një herë do t'i dërgojë 10 kopje të statutit Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë.

Baza ligjore

Neni 74: Për çështjet që nuk janë parashikuar nga kjo Kontratë, do të zbatohen ligjet në fuqi.

Instituti i Industrisë Mekanike dhe Kimike, Sumerbank, Etibank, Türkiye İş Bankası A.S, Türk Tecim Inc., Co., Niyazi Artunkal, Paul Millioon, Celal Imre, Macit Selem, Zeki Turgay.

Leja për themelimin e MITAS është dhënë në përputhje me vendimin e bordit të këshillit të ministrave datë 19.07.1995 me numër 4/5560. Kontrata kryesore përmban 74 nene siç është miratuar.

Minsitri i Ekonomisë dhe Tëgtrisë

Vërtetohet se kjo kopje është e njëjtë me origjinalin e shoqërisë MADENİ İNŞAAT İŞLERİ TÜRK ANONİM ŞİRKETİ marrë nga Fletorja e Regjistrat Tregtar e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Ankarasë, datë 11 shtator 1995 me numër 14 nga faqet 1.2.3 dhe 4 Fletorja e Regjistrat Tregtar e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Ankarasë datë 7 shtator 1995 me numër 15 nga faqja 2 që i përket të njëjtës shoqëri dhe një kopje mbahet në zyrën tonë dhe pasi nënshkruhet tetë kopje i jepen personave të interesuar. Dhjetë janar dymijë e shtatëmbëdhjetë.

10.01.2017

Nr. 00723

Nënshkrimi, vula
Në emër të noterit të 25-të
Mustafa Yurtdan
Nëpunës i autorizuar

KOPJE
Noteri i 25 i Ankarasë
Nr:22/2
Tel:229 72 43-Ankara
Kjo kopje është e njëjtë me origjinalin e depozituar pranë zyrës sonë.
Memet Unal
-firma, vula-

Nr. 54707
Kjo kopje është e njëjtë me origjinalin e depozituar pranë zyrës sonë dhe një kopje ju dorëzuar personit.
Dokumenti i paraqitur është i njëjtë me origjinalin.
25 Dhjetor 2006
-firma, vula-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



DATE 23/12/2020
NR REP 10942/14

VËRTETIM PËRKTHIMI

Vërtetohet firma e përkthyeses zj. Ermira Laknori, banuese në Tiranë, përkthyesë zyrtare e gjuhës angleze e njohur nga Ministria e Drejtësisë, e cila deklaroi se ka përkthyer sa më sipër njëllor me origjinalin nga anglisht në shqip dhe nënshkroi rregullisht para meje.

NOTERE



NOTERE
Majlinda E. Demolla
NR REP: K416000000
23.12.2020



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI**



NR.10943 REP. 18

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 23/12/2020, para meje Noteres MAJLINDA DEMOLLARI, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NJESIA ADMINISTRATIVE NR.5, RR. VASO PASHA, GODINA NR. 1, APARTAMENTI NR.3, HYRJA NR .10, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Shoqëria BOZO & ASSOCIATES, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L01313004E, përfaqësuar nga Administratori Artan Bozo, atësia Pali, amësia Naunka, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, lindur më 28/08/1969, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035059561 dhe nr. personal G90828133L.

I cili me kerkoi te beje vertetimin e kopjes me originalin te dokumentit:

-Statut

Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit original me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta; Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Notarinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin original.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER
MAJLINDA DEMOLLARI**

NOTERE
Majlinda E. Demollari
NIP: 90160